**VENDIM**
**Nr. 517, datë 25.7.2019**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 246, DATË 24.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E ULËT DHE TË MESME DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË JASHTË SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2019"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 246, datë 24.4.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

1. Në shkronjën "a", të pikës 2, shifra: "... 13 ..." bëhet: "... 15 ...".

2. Në pikën 3, fjalët: " ... gjithsej 13, ..." zëvendësohen me: " ... gjithsej 15, ...".

3. Në ndarjen I, "Niveli i mesëm drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr.1, që përmendet në pikën 3, bëhen shtesat, me këtë përmbajtje:

"14. Drejtor i Huamarrjes, në Drejtorinë e Përgjithshme të Borxhit Publik dhe Bashkërendimit të Ndihmës së Huaj, në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë – kategoria II-b;

15. Drejtor i Drejtorisë së Sistemeve Informatike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile- kategoria II-b.".

4. Në ndarjen II, "Niveli i ulët drejtues dhe të barasvlershëm", të lidhjes nr.1 që përmendet në pikën 3, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Emërtesat e përmendura në pikat 27 deri në 31, zëvendësohen, si më poshtë vijon:

"27. Kryetar, Dega Doganore Kakavijë, kategoria III-a;

28. Kryetar, Dega Doganore Rinas, kategoria III-a;

29. Kryetar, Dega Doganore Shkodër, kategoria III-a;

30. Kryetar, Dega Doganore Kukës Morinë, kategoria III-a;

31. Drejtor, Drejtoria e Antikorrupsionit dhe Standardeve Profesionale, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave", kategoria III-a;".

Pas pikës 35, shtohen pikat 36 dhe 37, me këtë përmbajtje:

"36. Përgjegjës i sektorit të lajmeve ekonomike dhe politike, në Drejtorinë e Lajmeve dhe Multimedias, në Agjencinë Telegrafike Shqiptare - kategoria: III-a/1;".

"37. Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe i Shërbimeve Mbështetëse, në Agjencinë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural – kategoria: III-a.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
**Edi Rama**